



Primar / Doretuar Punëjohë/Prodato Received/Delivered	20-05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMBICK	2959/2022		117	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.349/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: : Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.349/2022 me datë 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

adresë: kundër Agjencinë shtetërore të Arkivave të Kosovës, në çështjen juridike **“Vlerësimi i rezultateve të punës”**, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.349/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

**II. NDRYSHOHET** Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2021 i datës 24.03.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen nga nota (2.39) në notën e përgjithshme mirë (2.66).

**III.** Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë si në pikën **II** të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.

**IV. OBLIGOHET** Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

**V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Agjencinë shtetërore të Arkivave të Kosovës, sipas Akte emërimit Nr.08 të datës 28.03.2011 në pozitën **“Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa”**, e cila

me datë 28.03.2022 ka pranuar Formularin e Vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 i nënshkruar me datë 24.03.2022, nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë gjegjësisht Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë shtetërore të Arkivave të Kosovës, me notë të përgjithshme 2.39, të pranuar dhe të nënshkruar nga ankuesja me datë 28.03.2022.

Ankuesja me datë 29.03.2022 përmes emailit zyrtar e ka njoftuar Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë se e kundërshton vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, duke dhënë komentet e saja, për të cilin njoftim me datë 31.03.2022 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë përmes E-mailit zyrtar kërkon nga ankuesja që t'ia sjell fizikisht formularin për të dhënë komentet e tij, dhe keto komente i janë dërguar ankueses me datë 05.04.2022.

Ankuesja e pa kënaqur me Vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, të pranuar me date 28.03.2022 dhe pas komenteve të datës 05.04.2022 të dhëna nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, me datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 1970/2022, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë është jashtë afatit ligjor si dhe në kundërshtim me gjendjen faktike duke pretenduar në pjesën e III, vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale në pikën 1.5, që e ka notën një(1), në kundërshtim me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 14.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Agjencinë shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 26.04.2022 ka pranuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa A.nr. 349/2022 e datës 08.04.2022 me numër protokollit 1970/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailit i datës 29.03.2022; E-mailit i datës 31.03.2022; Formulari i datës 24.03.2022, për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, i nën shkruar me datë 28.03.2022; E-mailit i datës 01.04.2022; Procesverbali i datës 10.11.2021; Kërkesë e datës 03.12.2021; Vendimi i datës 29.09.2021; Vendimi i datës 21.10.2021; Vendimi Nr.10/46 i datës 30.11.2021; Lista e pagesave të lista e pagave e datës 31.12.2021; E-mailit i datës 24.11.2021; E-mailit i datës 20.10.2021; E-mailit i datës 13.10.2021; E-mailit i datës 18.10.2021; E-mailit i datës 25.10.2021; E-mailit i datës 08.12.2021; E-mailit i datës 01.12.2021; E-mailit i datës 07.12.2021; E-mailit i datës 07.12.2021; E-mailit i datës 11.12.2021; Kërkesë e datës 10.12.2021; E-mailit i datës 25.11.2021; E-mailit i datës 24.12.2021; E-mailit i datës 07.12.2021; Aktgjykim PA1.nr.997/2021 i datës 14.09.2021; Vendim i datës 05.11.2015; E-mailit i datës 22.11.2021; Deklarata e nevojave dhe percaktimit të disponshmërisë së fondeve e datës 22.11.2021; E-mailit i datës 12.11.2021; Fatura e datës 08.11.2021-Fletedergesë e datës 20.01.2020; Procesverbali 07.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 26.04.2020; Akt emërimi nr.08 i datës 28.03.2011; Vendimi i datës 20.09.2010; Formulari i datës 30.12.2019, për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2019; Letë përcjellëse e datës 26.04.2022; Vendimi i datës 21.10.2021; E-mailit i datës 18.10.2021; E-mailit i datës 15.11.2021; E-mailit i datës 22.11.2021; Vendim Anr.141/2022 i datës 01.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit Nr.08 të datës 28.03.2011 mbanë pozitën ''Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa'', në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë

për vitin 2021 më datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021 të datës 24.03.2022 e pranuar nga ankuesja me datë 28.03.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është jashtë afatit ligjor është në kundërshtim me gjendjen faktike sa i përket pjesës së III, vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale në piken 1.5, gjegjësisht në kundërshtim me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Lidhur me pretendimin e ankueses e cila pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, është nxjerrë jashtë afatit ligjor, të cilin e ka pranuar me datë 24.03.2022 dhe është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.39, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës të ankueses dhe organi të punësimit gjegjësisht Agjencisë shtetërore të Arkivave të Kosovës, ka konstatuar se pretendimi i ankueses është i bazuar sepse formulari i vlerësimit për rezultatet e punës për vitin 2021 ankueses i është dorëzuar me datë 24.03.2022 nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejtë respektivisht nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë shtetërore të Arkivave të Kosovës, jashtë afatit ligjor, ashtu siq përcaktohet me dispozitën ligjore të nenit 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku theksohet se: **“... Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues”**, lidhur me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **“2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”**.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesë e protokolluar me numër:1306/2022 të datës 14.04.2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: **“Takimin ndërmjet ankueses dhe udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë lidhur me vlerësimin e punës dhe përmbushjen e objektivave të punës”**, dorëzuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, përmes shkresës së datës 26.04.2022 e dorëzuar për mes udhëheqësit të ankueses, andaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore kanë kthyer përgjigje, mirëpo nuk ka arritur të dëshmojnë me fakte dhe prova të ligjshme se cilat kanë qenë realisht objektivat punës së ankueses për vitin 2021 për të cilat janë pajtuar ankuesja me udhëheqësin e saj, siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: **“1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet; 3.Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e nënshkrimit të Formularit të Vlerësimit me datë 24.03.2022 të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se : **“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesionale të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1. takimi për**

*diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.2. vlerësimin (notimi) e objektivave''*, sepse në rastin konkret vlerësimi i është dërguar ankueses përmes e-mailit zyrtar që është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se : **''Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit''**, që në rastin konkret organi i punësimit nuk e ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesja është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesja pasi ka pranuar vlerësimin e datës 24.03.2022, me datë 28.03.2022 i ka dhënë me shkrim mospajtimin e saj, brenda afatit prej 5 ditëve, në pajtim me dispozitën e lartë cekur.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuese për vitin 2021 të datës 24.03.2022 të nënshkruar nga ankuesja me komente me datë 28.03.2022, Kolegji ka konstatuar se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen, respektivisht përcaktimit të notës mesatare nuk ka zbatuar në përpikshmëri dispozitat e përcaktuara në nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: **''1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit; 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar; 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar; 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive''**, ngase sipas vlerësimit me formulën e përcaktuar si më lartë nota e përgjithshme e vlerësimit del të jetë me e lartë e jo siç është vendosur nga udhëheqesi, kalkulim ky i cili ankuesen e ka dëmtuar në kuptim të kategorizimit apo ndarjes dhe kuptimit të notave të vlerësimit në bazë të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Po ashtu, Kolegji në përgjigjen e datës 26.04.2022 të protokolluar më numër 2364/2022 dërguar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, si dhe shkresën përcjellëse të datës 26.04.2022 me numër protokoll 01/127/22 të Kryeshefit Ekzekutiv, nuk ka pranuar fakte të provueshme se ankuesja ka raportuar gjatë vitit kalendarik 2021 tek udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, si dhe për rastin e \_\_\_\_\_ që përfshirë si rast nga kjo letër përcjellëse me dyshimin se ankuesja nuk i ka përmbushur detyrat e punës me rastin e mos realizimit të kompensimit për \_\_\_\_\_ në shumën e mbetur të 50% të pagës së mbetur, sipas Vendimit të datës 21.10.2021 me numër protokoll 01/2051/21 të nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv, për \_\_\_\_\_ sipas Aktgjykimit P.nr. 5906/17 të Gjykatës Themelore në Prishtinë të vërtetuar me Aktgjykim Nr.Pa1.nr.997/2021 të Gjykatës së Apelit, për të cilën çështje në bazë të provave të lëndës është konstatuar se ankuesja i ka përmbushur detyrat e punës sipas kompetencës, të bashkangjitur procesverbalet e takimit që ka të bëjnë me procedurën e zhvilluar për të realizuar kompensimin e \_\_\_\_\_ sepse pretendimet e theksuara në letër përcjellëse të Kryeshefit Ekzekutiv, i cili është Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, nuk janë të bazuara në fakte dhe si të tilla nuk janë të qëndrueshme sepse ankuesja ka bërë veprimet e saja konform kompetencës që ti realizoj detyrat e punës profesionale për \_\_\_\_\_ por në mungesë të buxhetit kjo qeshtje ka mbet në pritje të një përgjigje nga Vendim i Qeveris për lëvizje të buxhetit, siç është cekur në dëshmin e Procesverbalit të mbledhjes urgjente të datës 10.11.2021, në faqen e dytë pika **II. pagesa e B.P**, citoj: **''Kryeshefi Ekzekutiv-ku ka mbet puna për pagesën e B....? \_\_\_\_\_ i Qeveris Mbetet me u marrë për lëvizje të buxhetit në të gjitha institucionet. Zyrtarja e MKRS, më tha që të njoftoj me momentin që merret vendimi. Kryeshefi Ekzekutiv-edhe ata kur nuk japin zgjidhje mu s'me metët tjetër se pos me i than zyrtarit vazhdo ti me përmbarues, .....u bën dy muaj e kjo pune s'po gjen zgjidhje .....**

*bisedo dhe angazhohu prape me i gjet zgjidhje, duke kërkuar që të behët transferim i parave nga kategoria mallra dhe shërbimeve në kodin për pagesa dhe aty menjëherë pajtoj ti behet pagesa insisto çdo dit se vetëm po t'u shkruash ata nuk merren me këtë çështje.....Ne nuk duhet te lejojmë të zvarritet kjo çështje dhe zyrtari të shkoj të realizoj këtë te drejtë përmes përmbartuesit se na bëhet më shtrenjtë.....”.*

Në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimet e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses nuk janë të bazuara sipas arsytimit të tij në këtë shkresë përcjellëse, me dyshimin se ankuesja nuk i ka përmbushur detyrat e punës, dhe për këtë shkak ka marr vlerësimin e punës për vitin 2021 me të ulët se nota 5 dhe 4, të cilat pretendime nuk janë të qëndrueshme sepse në bazë të procesverbal të datës 10.11.2021 është vërtetuar se ankuesja i ka përfunduar detyrat e punës me profesionalizëm, duke bërë veprimet konform kompetencës dhe procedurave ligjore të punës profesionale, për çështjen e filluar lidhur me kompensimin e të cilit i është realizuar kompensimi në muajin dhjetor 2021, bazuar në listën e pagave të datës 31.12.2021 dhe shkresën zyrtare të datës 10.12.2021, formulari për pagesë retroaktive për listën e pagave për të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe nëpunësit të autorizuar.

Kurse, sa i përket pretendimeve të tjera që lidhen me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen, të deklaruara në letrën përcjellëse të datës 26.04.2022 me numër protokolli 01/127/22 të Kryeshefit Ekzekutiv gjegjësisht Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me dyshimin se ankuesja ka refuzuar punën lidhur me mos nënshkrimin e formularit të datës 22.11.2021 për deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, për procedurën e rregullt të servisimit të rregullt të veturës tipi “Suzuki”, të ASHAK, edhe ky arsyetim është i pa bazuar, sepse për këtë çështje është konstatuar se në shkresat e lëndës është gjetur se ankuesja e ka njoftuar mbikëqyrësin e saj konform përgjegjësisve duke dhënë arsyetimin e saj në përgjigjen e datës 22.11.2022 përmes e-mailit zyrtar, **citohet**: “... formularit e disponueshmërisë së fondeve për servisimin e automjetit nuk e nënshkruaj edhe pse ka mjete. Arsyeja...duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ me Nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës neni 8 vetura zyrtare nuk guxon të mbahet pa servisi ( 2 vite gati pa servisim) pasi që është pasuri e ASHAK. Së dyti vetura është e aksidentuar pa proces të policisë ku duhet ti përmbahemi Udhëzimit Administrativ nenit 12 paragrafi 12.1....”, që në rastin konkret ankuesja nuk ka refuzuar punën por ka njoftuar mbikëqyrësin e saj, për çështjen kryesore konform përgjegjësisë së plotë ligjore, duke u përcaktuar në dispozitat ligjore në fuqi, e cila ka vepruar në pajtim me nenin e 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është e përcaktuar se: “**Detyrimi i përgjegjshmërisë: Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij**”.

Andaj, pas vlerësimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe pas analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, duke u bazuar në gjeturat e pasqyruara si më lartë në këtë vendim, Kolegji ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe faktike me prova konkrete se ankuesja ne baze te vleresimit me notë 2.66 i ka arritur objektivat, andaj eshte e palogjikshme që ne pjesën e III tek „Vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale” pika 1.5 „Komunikimi dhe Perfaqesimi” te thuhet se ankueses i mungon komunikimi, perfaqesimi dhe angazhimi, e te e vleresohet me noten me te ulte 1, ndersa ne anen tjeter ankuesja ne baze te vleresimit ka arritur ti permbushte te gjitha objektivat, logjikisht pa komunikim dhe angazhimin e ankueses nuk do te mund te arriheshin objektivat, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se të njëjtës vendosi t’i ndryshojë notën e e pergjithshme të vlerësimit për vitin 2021, gjegjesisht notën e përgjithshme mesatare nga dy pikë tridhjetë e nëntë (2.39) në dy pikë e gjashtëdhjetë e gjashtë (2.66), në pajtim me nenin 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: “*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo*

ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit). Po ashtu nga provat e lëndës është konstatuar se metodologjia e vlerësimit të rezultatit përfundimtar për vitin 2021 për ankuesen nuk ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 10 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, dhe si rrjedhojë e kësaj metodologjie mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 si dhe paragrafit 2 nën paragrafit 2.3 i të njëjtit nen të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton " mirë"; dhe Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: " mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës;*" që në rastin konkret organi i punësimit gjegjësisht Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, pas ndryshimit të formularit të vlerësimit të rezultateve për vitin 2021 të datës 24.03.2022, ankueses ky vlerësim përfundimisht ti behet me notë të përgjithshme dy pikë e gjashtëdhjetë e gjashtë (2.66)në pajtim me dispozitat e cekura si me lartë që nënkupton "mirë".

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafin 1 ,2 paragrafin 3 ,7 dhe 10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, është konstatuar se vlerësimi për rezultatet e punës për vitin 2021 për ankuesen është nxjerrë jashtë afatit ligjor me datë 24.03.2022, dhe është bërë llogaritja në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë / Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë shtetërore të Arkivave të Kosovës, vlerësimi si i tillë është i pa ligjshëm siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *" 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:.....1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative"*.

Po ashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës duhet të kujdesët që vendimi i Këshillit të vendoset në dosjen personale të ankueses në pjesën ku mbahet regjistri i vlerësimeve të rezultateve në punë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar dhe në nenin 13 paragrafit 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *' 4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor , vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)''*

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për

Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.349/2022.**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së .